



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacionii Bashkimit Evropian

Shkup, 19 dhjetor 2012

**Evenimenti i përmbylljes së projektit të financuar nga BE-ja:
“Përkrahja e punësimit të të rinjve, femrave dhe personave që
nuk punojnë një kohë të gjatë”**

(Hotel Aleksandar Palas)

Fjalim nga
Shkëlqesia e Tij, z. Aivo ORAV
Shef i Delegacionit të BE-së

I nderuari Ministër, z. Ristovski,
I nderuari Drejtor i Agjencisë për Shërbime Punësimi, z.
Popovski,
Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë që ndodhem pranë jush sot, për të ndarë me ju rezultatet e këtij projekti të financuar nga BE-ja, i cili kontribuoi në rritjen e punësimit të të rinjve, femrave dhe personave që një kohë të gjatë kanë qënë të papunë.

Siç e dimë të gjithë, papunësia e lartë është sfidë kryesore për vendin. Ndoshta madje, është sfida më e rëndësishme! Prandaj, luftimi i papunësisë nuk është vetëm në krye të agjendës politike të Shteteve Anëtare të BE-së, por edhe prioritet i programit mbështetës që e ofrojmë.

Në nivel evropian, Shtetet Anëtare të BE-së kanë vendosur të veprojnë në mënyrë kolektive, si Union, me anë të strategjisë Evropa 2020, e cila përcakton një vizion për ekonominë e tregut social të Evropës, për shekullin 21. Kjo strategji promovon zhvillimin efikas, të qëndrueshëm dhe përfshirës. Kjo krijon kornizën e përgjithshme sipas të cilës BE-ja vepron për të shtuar punësimin, produktivitetin dhe kohezionin social në Bashkimin Evropian.

Objektivat dhe parimet e njëjta vlejnë në masë të njëjtë për të gjitha vendet në rajon, si pjesë e reformave të nevojshme për të finalizuar procesin e tyre të integritit në Evropë.

Projekte të shumta financohen nga Bashkimi Evropian për të mbështetur qeverinë në përpjekjet për përmirësim të punësimit. Nga viti 2007 deri në 2013, BE-ja ofron gjithsej vlerën prej 54 milionë euro për të mbështetur këto aktivitete.

Politika e tregut aktiv të punës është relativisht e re për vendin, mirëpo përvoja në Shtetet Anëtare të BE-së ka vërtetuar se është mjet i fuqishëm për të luftuar papunësinë me sukses, për të shtuar përfshirjen sociale dhe për të përmirësuar perspektivat e përgjithshme ekonomike për qytetarët. Prandaj, përkrahja e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Agjencisë për Shërbime Punësimi, për implementimin e suksesshëm të masave për tregun aktiv të punës, ka qënë gurthemel i mbështetjes tonë aktuale. Jemi krenarë që sot do të prezantohemi me rezultatet e para të përpjekjeve tona të përbashkëta në këtë fushë.

Edhe pse ka pasur vonesa të mëdha në fillim të projektit, me kalimin e kohës implementimi është përshpejtuar dhe deri më sot, një numër i shquar 8400 njerëz, u trajnuan dhe

mundën të fitojnë përvojë të vlefshme pune në suaza të kësaj iniciative.

BE-ja plotësoi Programin Nacional Operativ për masat aktive të tregut të punës, përmes të një granti të drejtpërdrejtë për një Agjenci të Shërbimeve të Punësimit. Kjo u bë për herë të parë. Sot, kjo përfaqëson modelin që duhet marrë parasysh për aktivitetet e ardhshme, jo vetëm në vend, por edhe në rajon.

Ngjarja e sotme është mundësi e mirë për të theksuar punën e të gjitha palëve pjesëmarrëse, por edhe për të diskutuar mësimet dhe përvojat e nxjerra në aspektin e planifikimit të aktiviteteve të ardhshme – pasi që BE-ja do të vazhdojë t'ju mbështesë për të luftuar papunësinë, me anë të politikës aktive të tregut të punës!

Në fund, dëshiroj të falënderoj për përpjekjet e të gjitha palëve të involvuara në këtë projekt dhe t'u uroj implementimin e suksesshëm të projektit.

Ju falemnderit për vëmendjen!